

20 Prot



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCEVE DHE EKONOMISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PRONËS PUBLIKE
DREJTORIA E PRIVATIZIMIT

Nr. 1903 Prot.

Tiranë, më 25.10.2018

URDHËR

Nr. 287 datë 25.10.2018

PËR

BASHKIMIN ME SHOQËRINË “PETROL ALBA” SH.A. NË LIKUIDIM, ME ANË TË PËRTHITHJES TË SHOQËRISË “SHPËRNDARJA E LIBRIT SHKOLLOR” SH.A. NË LIKUIDIM

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të Ligjit nr. 8237, datë 01.09.1997 “Për disa ndryshime në ligjin nr.7926, datë 20.4.1995 “Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare”, të ndryshuar dhe nenit 191, të Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar, me cilësinë e aksionarit të vetëm,

URDHËROJ:

1. Bashkimin me shoqërinë “Petrol Alba” sh.a. në likuidim, me anë të përthithjes të shoqërisë “Shpërndarja e Librit Shkollor” sh.a. në likuidim.
2. Të hartohet marrëveshja dhe raporti i bashkimit, sipas përcaktimeve të nenit 216 të Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008, të ndryshuar.
3. Eksperti Kontabël i Autorizuar Znj. Vullnetare Çela, të hartojë raportin përkatës, sipas përcaktimeve të nenit 217 të Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008, të ndryshuar.
4. Shoqëria “Shpërndarja e Librit Shkollor” sh.a. në likuidim, pas përfundimit të bashkimit, referuar nenit 220 të të Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008, të ndryshuar, vlerësohet e prishur, ndaj çregjistrohet nga QKB-ja, sipas seksionit V të Ligjit nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, të ndryshuar.
5. Komandohet Znj. Nermin Bardulla, aktualisht juriste e shoqërisë “Shpërndarja e Librit Shkollor” sh.a. në likuidim, të kryejë funksionet e likuidatorit të shoqërisë, deri në përfundimin e procedurave të bashkimit.

Bledar Ahmeti

6. Përfundimi i marrëdhënieve të punës për punonjësit e shoqërisë “Shpërndarja e Librit Shkollor” sh.a. në likuidim, në përfundim të procedurave të bashkimit, të bëhet sipas përcaktimeve të Kodit të Punës.
7. Ngarkohen shoqëritë “Petrol Alba” sh.a. në likuidim dhe “Shpërndarja e Librit Shkollor” sh.a. në likuidim, për zbatimin e këtij Urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.



Bledar Ahmeti